



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E  
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija sa Upravlanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

---

<b>DATË/A:</b>	23.03.2015
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
<b>CC:</b>	Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Idriz Blakaj, Drejtor i AMKMK-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raport Vjetor i AMKMK-së

I nderuari Z.Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me këtë shkresë po iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2014.

Bashkëngjitur këtij Raporti do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2014.

Me respekt



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E  
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija sa Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Menagement of Memorial of the Complexes of Kosovo

---

RAPORT VJETOR I PUNËS

për vitin 2014

**Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës**

## **1. Përmbledhje Ekzekutive**

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është themeluar nga viti 2013 pas publikimit të GZRK datë 26.04.2013, 15 ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së.

AMKMK do të paraqes raportin vjetor përkitazi me përmbledhjen mbi të gjitha aktivitetet relevante lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale është organ i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, Agjencia trajton, mbikëqyrë, menaxhon çështje të ndryshme lidhur me Komplekse dhe Memoriale, duke nxjerrë vendime, rekomandime, duke hartuar Akte nënligjore dhe nxjerrë Memorandume dhe Marrëveshje Bashkëpunimi.

AMKMK ka rëndësi të posaçme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Në këtë raport theksojmë çështjet kryesore e që janë: korniza ligjore, buxheti i AMKMK-së, bartja e projekteve nga MMPH në AMKMK, kompletimi i stafit dhe sigurimi i zyreve dhe automjeteve për punëtor.

Arritjet e AMKMK-së për këtë vit të raportimit janë përmbushja e infrastrukturës ligjore sidomos nxjerrja e legjislacionit sekondar në tërësi, ndërsa objektivat dhe sfidat në të ardhmën mbeten rritja e buxhetit, bartja e projekteve nga MMPH në AMKMK dhe vendosja në një objekt tjetër në hapësirë më të gjerë për stafin e AMKMK-së.

## **2. Korniza Ligjore**

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK, deri me tani në këtë Agjenci janë nxjerrë disa Akte nënligjore:

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemen e Agjencisë së AMKMK-së, Rregullorja e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK, Rregullorja Nr.03/2014 për Punët në Teren, punët shtesë dhe jashtë orarit, Rregullore Nr.04/2014 për Caktimin e shpenzimeve të Telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së dhe tani në vazhdim jemi duke hartuar ProjektUdhëzimin Administrativ për përcaktimin e Kriteve për Komplekset dhe Memoriale të Kosovës që rrjedh prej Ligjit të AMKMK-së.

Deri në periudhën raportuese nuk ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacion.

Agjencia deri me tani nuk ka pasur vështirësi në zbatim të Ligjit.

### 3. Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)

**Misioni:** Krijimi i mundësive për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në Planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës dhe plani i menaxhimit të jetë në harmoni me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

**Vizioni:** Kompletimi dhe Funksionimi normal i Agjencisë, zhvillim të veprimtarisë në ngritjen dhe funksionalizimin e KM, dhe njëkohësisht shtimin e numrit të vizitorëve.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve me institucionet dhe organet tjera, ngritja e profesionalizmit për stafin e AMKMK-së.

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- përcakton programet kërkimore - shkencore, aktivitetet dhe manifestimet e ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitat përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- krijimin e VEB-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- propozon shpalljen e Zonave më interes të veçantë kombëtarë dhe me karakter historik.

Departamentet përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave janë: Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Departamenti i cili ende nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së buxhetit Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim.

#### **4. Fushëveprimi që e mbulon Institucioni**

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord.

Agjencia do të funksionoj me stafin e brendshëm që janë të punësuar në Agjenci dhe me stafin që do të jenë të punësuar në Komplekse dhe Memoriale.


Struktura e AMKMK-së do të jetë si në vijim:

- Drejtori i AMKMK-së dhe personeli mbështetës;
- Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
- Departamenti për Planifikim Projektim dhe Menaxhim të K.M.

Kapacitetet ekzistuese të AMKMK-së janë:

- Drejtori i AMKMK-së;
- Drejtori i FSHP-së;
- Udhëheqse e Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit;
- Udhëheqës i Divizionit Ligjor;
- Zyrtare për Burime Njerëzore;
- Zyrtar i Logjistikës;
- Asistente Administrative;
- Zyrtar për Arkiv.

Organogrami i AMKMK-së



## Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2014

<b>Të Punësuarit në AMKMK</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Emri Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>
<b>1.</b>	Idriz Blakaj	Drejtor i AMKMK-së
<b>2.</b>	Adnan Elshani	Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
<b>3.</b>	Besim Mulaj	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
<b>4.</b>	Albana Hajrizi - Kunushevc	Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa
<b>5.</b>	Arbër Këpuska	Udhëheqës i Divizionit Ligjor
<b>6.</b>	Sanie Elezi	Zyrtare e Burimeve Njerëzore
<b>7.</b>	Kastriot Ukaj	Zyrtar i Logjistikës
<b>8.</b>	Anita Balaj	Asistente Administrative
<b>9.</b>	Ferki Karaxha	Zyrtar i Arkivit

### **Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK**

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës aktualisht janë të punësuar nëntë (9) punëtor, duke përfshirë Drejtorin e AMKMK-së që është i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nevojat për punëtor të rinjë në AMKMK parashihen:

#### **Në Divizionin për Buxhet dhe Financa:**

Zyrtar Financiar – Një (1);

Arkatar – Një (1);

#### **Divizioni i Burimeve Njerëzore:**

Zyrtar për Komunikim Publik – një (1);

Gis dhe IT – një (1);

#### **Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim:**

Drejtor i Departamentit Planifikimit, Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve -një (1);

Udhëheqës i Divizionit për Menaxhim të Komplekseve - një (1);

**Ciceron - pesë (5):**

Ciceron në Prekaz Kompleksin “Adem Jashari” - 3 (tre);

Ciceron në Kompleksin e Reçakut - një (1);

Ciceron në Kompleksin “Zahir Pajaziti” - një (1);

Kërkesa për punësimin e punëtorëve të ri është paraparë për Komplekset Memoriale të përfunduara, kurse me përfundimin edhe të Komplekseve Memoriale tjera patjetër që duhet të rritet numri i stafit të të punësuarve.

**Rojtarë –Nëntë (9)**

Rojtarë në Kompleksin e Reçakut - tre (3);

Rojtarë në Kompleksin e Morinës - tre (3);

Rojtarë në Kompleksin “Zahir Pajaziti” - tre (3).

**PLANI VJETOR I TRAJNIMIT I NËPUNËSVE CIVIL**  
për periudhën Shkurt - Nëntor - 2015

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësëve civilë që duhen trajnuar	Përshtatja * me prioritetet e trajnimit	Titulli programit/kursit të trajnimit	Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Menaxhimi dhe planifikimi strategjik	2		Menaxhim i Përgjithshëm	IKAP	Prill
Menaxhimi dhe udhëheqja	2		Menaxhim i Përgjithshëm	IKAP	Prill
Menaxhimi i projekteve	2		Menaxhim i Përgjithshëm	IKAP	Nëntor
Roli i Kuvendit në hartimin e legjislacionit	1		Administratë e Legjislacion	IKAP	Prill
Procedurat administrative	1		Administratë e Legjislacion	IKAP	Qershor
Funksionimi i Administratës Shtetërore në Republikën e Kosovës	2		Administratë e Legjislacion	IKAP	Shtator



Komunikimi dhe hartimi i shkresave në ad. publike	1		Administratë e Legjislacion	IKAP	Maj
E drejta e qasjes në dokumente publike	2		Administratë e Legjislacion	IKAP	Prill
Menaxhimi dhe Zhvillimi i BNJ	1		Burime Njerëzore	IKAP	Prill
Kontrata kolektive	1		Burime Njerëzore	IKAP	Maj
Të drejtat, përgjegjësite dhe ankimimi ne SHC	1		Burime Njerëzore	IKAP	Maj
Rekrutimi dhe përzgjedhja	1		Burime Njerëzore	IKAP	Qershor
Prokurim publik-bazik	1		Buxhet dhe Financa	IKAP	Prill
Administrimi i financave publike	1		Buxhet dhe Financa	IKAP	Prill
Përafrimi i legjislacionit vendor me legjislacionin BE-së dhe tabelat e pajtueshmërisë	2		Bashkim Evropian	IKAP	Prill-Maj
Program trajnimi fillestar për BE-në dhe procesin e Integritimit Evropian	3		Bashkim Evropian	IKAP	Prill-Maj
Parimet dhe objektivat e administratës moderne në mjedisin administrativ Evropian	2		Bashkim Evropian	IKAP	Maj-Qershor

## Asetet që ka në disponim AMKMK

Nr.	Emërtimi	Kodi i projektit	Kodi ekonomik	Shuma €
1	Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari	13280	31900	28,480.14
2	Mirëmbajtja e web faqes së K.M Adem Jashari	13851	31900	2,233.28
3	Krijimi i web faqes së AMKMK-së	13851	31900	6,850.00
4	Kapital tjetër - Ndërtimi i gypit për ujitjen e gjelbërimit	13851	31260	795,114.95
5	Kapitale - Caktimi i kufirit në K.M Adem Jashari	13851	31900	39,499.74
6	Kapitale - Konservimi i K.M Adem Jashari	13851	31900	282,879.30
7	Mbikëqyrja e projektit – ujësjellësi	13851	31260	9,780.28
8	Kapitale – Hartimi i planit të menaxhimit të K.M Adem Jashari	13851	31900	44,900.00
9	Vetura NISSAN TERRANO II (donacion nga Kuvendi i Kosovës)			0.00

\*Shuma totale e asetëve është paraqitur në vlerën përfundimtare blerëse

**Totali për 2014 = 1,209,737.69€**

Është formuar një komision në mes MMPH-së dhe AMKMK-së për bartjen e të gjitha projekteve kapitale në AMKMK që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale, që aktualisht janë si projekte në vazhdimësi të MMPH-së. Komisioni ende nuk e ka përfunduar punën, por planet janë që të gjitha Komplekset Memoriale të menaxhohen nga AMKMK dhe njëkohësisht do të jenë si asetë të reja të AMKMK-së.

### Hapësira për punë:

Deri me tani i kemi vetëm dy zyre në katin e III të Ndërtesës së Kuvendit të Kosovës që nuk janë të mjaftueshme edhe përkundër kërkeses së bërë me kohë Departamentit të Inxhinjeringut në Ministrinë e Administratës Publike.

Në fillim të shtatorit të vitit 2013 nga Kuvendi i Kosovës na u ofruan përkohësisht dy zyra në objektin e Kuvendit që nuk janë të mjaftueshme.

## **5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese**

Aktivitetet të cilat janë ndërmarr vitin e kaluar:

- Bartja e projekteve të Komplekseve dhe Memorialëve nga MMPH sipas Ligjit për Agjencinë në AMKMK të cilat deri me tani ende nuk janë bartur;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2014.

Aktivitete tjera ishin:

- Përfundimi i ndërtimit të gypit për furnizimin e Kompleksit me ujë për ujitjen e gjelbërimit është përfunduar;
- Mbikëqyrja e projektit për ndërtimin e gypit për furnizimin me ujë në K.M Adem Jashari – Prekaz;
- Caktimi i pikave të kufirit të K M “Adem Jashari” Prekaz është përfunduar projekti;
- Punësimin e stafit të nevojshëm pa të cilët nuk do të mund të funksionoj Agjencia;
- Hartimi i projektit të Konservimit të shtëpive të Rezistencës në K M “Adem Jashari”;
- Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e K M “Adem Jashari”;
- Hartimi i Planit të Menaxhimit të K M “Adem Jashari”;
- Krijimi i webfaqes së AMKMK-së dhe mirëmbajtja e saj;
- Mirëmbajtja e webfaqes së K M Adem Jashari – Prekaz Skenderaj;
- AMKMK ka arritur marrëveshje me shoqërinë aksionare “SH.A. IBËR LEPENC” për kyqjen në sistemin e ujitjes dhe shfrytëzimit të ujit për ujitjen e gjelbërimit në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”;
- Hartimi i Akteve nënligjore tjera;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017;
- Planifikimi i Buxhetit të AMKMK-së sipas Qarkoreve Buxhetore (tri Qarkore Buxhetore);
- Hartimi i Raportit dhe Pasqyra Financiare për periudhën nëntë mujore të vitit 2014;
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit çdo tre muaj.

**Planet që parashikohen për vitin vijues:**

- Rritja e Buxhetit për AMKMK;
- Vendosja në objekt tjetër në zyre të tjera të punës;
- Bartja e projekteve nga MMPH në AMKMK;
- Inicimi i procedurave të Prokurimit për fillimin e ekzekutimit të konservimit të shtëpive të rezistencës në Kompleksin Memorial Adem Jashari Prekaz Skenderaj, pastaj procedura e shpalljes së konkursit për hartimin e projektit të përgjithshëm Urbanistik. Blerjes dhe mbulimit të 59 fidaneve simbol i të rënëve në Betejen e 5, 6, 7 Mars 1998.

- Hartimin e Elaboratit të shpronësimit për 20 hektarët në qendër të Kompleksit ku parashihet rregullimi i hapsirës gjelbëruese dhe shetitoret;
- Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari – Prekaz, Skënderaj;
  - Kompletimi i stafit;
  - Inicimi i proceduarave për ekzekutimin e punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares-Koshare Gjakovë, faza e dytë;
  - Inicimi i procedurave për ekzekutimin e punimeve në Kompleksin Memorial Dëshmoret e UÇK-së- Penuhë -Podujevë;
  - Përzgjedhja e kompanisë profesionale mbikëqyrëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të projekteve të AMKMK-së;
  - Ngritja e kapaciteteve të stafit, trajnime dhe seminare;
  - Mirëmbajtja e web faqes së AMKMK-së dhe K.M Adem Jashari, Prekaz - Skënderaj;
  - Bashkëpunimi me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
  - Plotësimi i stafit me punëtor të ri.

Agjencia ka pasur shumë sfida vitin paraprak si mungesa e buxhetit, hapësira jo të mjaftueshme me zyre, mungesa e stafit, mungesa e veturave, ngecja dhe mosbartja e projekteve nga MMPH në AMKMK.

Lidhur me këto AMKMK ka zhvilluar aktivitetet duke bërë kërkesat për rritjen e stafit, për projekte kapitale dhe sigurimin e hapësirave ku do të vendosej stafi i AMKMK-së.

Planifikimi i paraparë për vitin vijues, Agjencia do të bëjë përpjekje për realizimin e këtyre çështjeve të rëndësishme që u përmendën më sipër.

## **6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet/ sfidat e Institucionit ( Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)**

Agjencia ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.04/L-146 të AMKMK-së për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e veta nga viti paraprak, mirëpo objektivat të cilat nuk janë arritur arsyetim ka qenë mungesa e ndarjes së buxhetit të mjaftueshëm për shtimin e stafit nga MF, hapësirat e reja për zyre dhe bartja e projekteve nga MMPH në AMKMK.

AMKMK gjatë vitit 2014 ka arritur që të çertifikoj zyrtarët për zotimin e mjeteve për pranim të mallit, shpenzim, çertifikim, para të imta dhe avans. Me këto detyra janë ngarkuar Zyrtarët e AMKMK-së si detyrë shtesë të ngarkuar për funksionimin normal të Agjencisë.

Planifikimi për vitin vijues do të fokusohet në arritjen e këtyre qëllimeve, dhe objektiv tjetër do të jetë ngritja, funksionalizimi dhe menaxhimi i Komplekseve dhe Memorialeve që janë në përgjegjësi të AMKMK-së si dhe formimi i një stafi profesional dhe të kualifikuar në fushat përkatëse të Agjencisë.

## 7. Raporti Financiar

Shpenzimet e buxhetit të AMKMK-së për vitin 2014:

	<b>Buxheti vjetor me Ligjin e Buxhetit (2014)</b>	<b>Buxheti përfundimtar 2014</b>	<b>Shpenzimet 2014 (€)</b>	<b>Buxheti i shpenzuar (%)</b>
<b>Paga dhe mëditje</b>	57,068.00	57,068.00	50,722.19	89
<b>Mallra dhe shërbime</b>	30,000.00	25,500.00	24,665.26	97
<b>Shpenzime komunale</b>	5,000.00	22,285.00	22,004.64	99
<b>Investimet kapitale</b>	1,075,000.00	987,721.29	675,599.37	68
<b>Totali</b>	<b>1,167,068.00</b>	<b>1,092,574.29</b>	<b>772,991.46</b>	<b>67</b>

\*Buxheti i AMKMK-së për vitin 2014 është paraqitur detajisht në Raportin Vjetor Financiar sipas formularit të Kuvendit të Kosovës.

## 8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

AMKMK gjatë vitit 2013 nuk ka pasur auditim nga ZAP.

Auditori i Përgjithshëm e ka audituar AMKMK për vitin 2014 në dy faza por që ende nuk kemi marrë raportin final të tyre. Për këtë arsye ne nuk mund ta paraqesim pasqyrën e raportit dhe rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

## 9. Shtojcat

Vendime të ndryshme janë nxjerrë si:

- Vendimi për Formimin e komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e ofertave;
- Për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendim për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projektit ideor dhe kryesor në konservimin e shtëpive të rezistencës në Komplexin Memorial “Adem Jashari” Prekaz- Skenderaj;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për dizajnimin e vulës dhe stemës së AMKMK-së;
- Vendim për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;

- AMKMK gjatë vitit 2014 ka pranuar si donacion nga Kuvendi i Republikës së Kosovës një veturë NISAN TERRANO II, e cila na ka lehtësuar në realizimin e aktiviteteve tona në teren.

Prandaj për funksionimin dhe kompletimin e stafit të AMKMK-së, konstatojmë se është e domosdoshme të ketë rritje të Buxhetit të Agjencisë nga Ministria e Financave dhe bartjes së projekteve nga MMPH për Komplekset dhe Memorialet, për këtë arsye konsiderojmë se do të përmirësohet, dhe përmbushen detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i parasheh Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Me respekt.